



| | | | |
|--|---------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Planuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivered | 19.08.2022 | 2 | viti god year |
| Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit | Nr. Prot Br. Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKM8HCK | 4833/2022 | | 1/4 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.623/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.623/2022 të datës 15.07.2022 të parashtruar nga ankuesi nga kundër organit të punësimit Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.623/2022 të datës 15.07.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 15.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4150/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Konkursit me numër reference RN00008814 dhe numër protokolli 16151/2022/02 të datës 14.04.2022 për pozitën “Drejtor”, në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Gjakovë si dhe emërimin e drejtores në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Gjakovë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 19.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa Këshilli, më datë 07.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4150/2022 të datës 15.07.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Shtojcën e diplomës me numër REf.3479/1

të datës 16.10.2013; Diplomën e me Nr.2776 të datës 30.09.1988 të ankuesit; Kontratën e marrëdhënies së punës (numri dhe data e pa evidentuar); Provën shtesë me numër të protokollit 4190/2022 të parashtruar nga ankuesi e cila në Këshill është pranuar me datën 19.07.2022; CV e ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 19.07.2022; Përgjigjen me numër protokollit 4451/2022 të datës 01.08.2022; Vendimin me Nr.17/2021 të datës 04.11.2020 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore lidhur me deklarin e statusit të ankuesit; Konkursin me numër protokollit 16151-2022/02 të datës 14.04.2022; Kontratën e punës me numër 690/2019-05 të datës 04.03.2019; Vlerësimin individual të kandidateve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj; Përmbledhjen e vlerësimit individual nga Komisioni rekrutues; Renditjen përfundimtare të kandidateve; Raporti final i rekomandimit nga Komisioni rekrutues i datës 04.07.2022; Listën e ngushtë për intervistë të datës 04.07.2022; Njoftimin me numër protokollit 2982/2022 të datës 08.07.2022 për kandidatin e suksesshëm; Emalin e datës 22.06.2022 të drejtuar Listën e ngushtë për testin me shkrim të datës 22.06.2022; Përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj; Përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë me numër të Referencës RN00008814; Raportin verifikues me numër protokollit 2540/2022 të datës 10.06.2022 për kandidatet të cilët kanë aplikuar për pozitën "Drejtor i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë" në Gjakovë; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar më datë 28.05.2022; Vendimin me Nr.78/2022 të datës 18.05.2022; Vendimin me numër 92/2022 të datës 16.06.2022; Dosja e aplikimit të ankuesit Formulari i kërkesës për punësim me numër reference RN0000881 të datës 15.05.2022; Dokumenti i identifikimit; CV; Letrën- sqaruese (pa date), drejtuar Komisionit vlerësues nga ankuesi; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 14.12.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 31.12.2021; Referencën e datës 24.09.1990; Referencën e datës 10.05.2022; Referencën e datës 21.03.2000; Vërtetimin e datës 06.05.2022; Librezën e punës të datës 17.02.1983; Listën e pagave për periudhën kohore 01.03.2022 deri me datën 31.03.2022; Certifikatën e datës 15.04.2022 nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke e zhvilluar procedurën penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë; Diplomën me Nr.2776 të datës 30.09.1988; Shtojcën e diplomës me numër Ref.nr.3479/1 të datës 16.10.2013; Certifikatën me numër 152-13/92 të datës 17.03.1992; Dosja e aplikimit të kandidatit Formularin e kërkesës për punësim të datës 23.05.2022; CV e kandidatit Diplomën me Nr.99 të datës 02.07.2008; Diplomën me numër 0017 të datës 31.10.2011; Vendimin Nr. reference 614-206 të datës 26.12.2019; Vërtetimin me numër 39 të datës 13.05.2022; Vërtetimin e notave me numër të protokollit 61 të datës 18.05.2022; Certifikatën (pa numër); Shkresën të datës 15.05.2009; Certifikatën e datës 08.05.2010; Certifikatën me Nr.4/2011; Certifikatën me numër 3/2012; Certifikatën me Nr.5/2013; Certifikatën 13-27.09.2014; Certifikatën e datës 15-28.05.2015; Certifikatën lidhur me kryerjen e shkollës për Integritet Evropian për Planifikim dhe Zhvillim Urban e vitit 2015; Letër rekomandimit me numër 1045 të datës 22.05.2018; Certifikatën e datës 04-15.07.2018; Diplomën e datës 08.01.2002; Certifikatën me numër 06/03-136213/03 të datës 30.06.2009; Certifikatën e datës 31.08.2006; Shkresën e datës 01.06.2006 deri me datën 01.08.2006; Vendimin me numër 05-V-132 të datës 23.07.2015; Vendimin me numër 19/2015 të datës 14.08.2015; Letër reference të datës 31.12.2016; Vendimin me numër 52/2016 të datës 03.10.2016; Vendimin e datës 28.09.2016 për përzgjedhjen e eksperteve teknik për shqyrtimin e ankesave në lëmi të ndryshme profesionale; Vendimin me numër 529/17 të datës 18.07.2017

mbi përzgjedhjen e eksperteve profesional të prokurimit dhe përzgjedhjen e eksperteve të jashtëm teknik në lëmi të ndryshme profesionale për shqyrtimin e ankesave të operatoreve ekonomik; Kontratën për shërbime të veçanta me numër të protokollit 590/17 të datës 18.07.2017; Letër referencën e datës 28.12.2012; Letër referencën e datës 27.12.2013; Letër referencën e datës 22.12.2014; Letër rekomandimin e datës 25.09.2009; Letër referencën e datës 21.09.2007; Certifikatën e shtetësisë me numër serik. SH 10129529 të datës 23.05.2022; Certifikatën e datës 12.04.2022 nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo gjykatë; Vërtetimin e datës 13.04.2022; Dokumentin e identifikimit; Emalin zyrtar të datës 22.08.2022 me numër të protokollit 4868/2022 të Drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përshkrimin e detyrave të punës me numër 1609/2022/02 të datës 14.04.2022 për pozitën Drejtor i Departamentit për Trashëgimi Kulturorë; Kontratën e punës me numër 690/2019 -05 për kohë të pacaktuar të datës 04.03.2019 të ankuesit; Emalin e datës 24.08.2022 me numër të protokollit 4937/2022 të drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës lidhur me deklarimin e statusit të nëpunësve në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturorë; Emalin zyrtar të datës 23.08.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës lidhur me deklarimin e statusit të nëpunësve në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturorë sipas DMZP-se; Listën e DMZP-se lidhur me deklarimin e statusit të nëpunësve në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturorë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale lidhur me çështjen, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi

SEPSE:

Sipas vlerësimit të shkresave të lëndës rezultoi se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit duke u bazuar në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 si dhe nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, më datë 14.04.2022 ka publikuar Konkursin me numër reference RN00008814 për pozitën e punës "Drejtor", në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturorë në QRTK në Gjakovë, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ndërsa i njëjti me datë 15.07.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim se ende sa konkursi në fjalë ka qenë i hapur, me datë 08.05.2022 këtë pozitë është emëruar zonja

Kolegji i Këshillit në kuptim të përcaktimit të pranushmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 2 ku përcaktohet se 3. *Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.* 4. *Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se zyrtarët profesional, drejtues dhe drejtues të lartë në kuadër të institucioneve publike të kulturës kanë statusin e nëpunësit të*

shërbimit publikë, andaj ankuesi në pozitën e punës "Arkitekt Punonjës Profesional" si pozitë profesionale në kuadër të Qendrës Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Gjakovë si organ publik me kompetenca të shërbimeve të kulturës, nuk ka statusin e nëpunësit civil, kështu që Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbim Civil, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.623/2022 të datës 15.07.2022 të parashtruar nga ankuesi

Po nga shkresat e lëndës Kolegji gjen së ankuesi ka krijuar marrëdhënia të punës me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbi bazën e Ligjit të Punës si dhe në bazë të verifikimit të statusit të zyrtarëve publikë rezulton së pozita Drejtor dhe Arkitekt Punonjës Profesional në Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Gjakovë janë kategorizuar pozita të nëpunësve të shërbimit publikë.

Marrëdhënia e punës e nëpunësit të shërbimit publik është trajtuar në pjesën V të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht neni 64 paragrafi 1 ka përcaktuar se: 1. *Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punësimit për nëpunësin e Shërbimit Publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës.*, dhe po mbi këtë bazë ligjore është bërë edhe shpallja e Konkursit për pozitën e punës "Drejtor", në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në QRTK në Gjakovë, kështu që në kuptim të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji udhëzon palën ankuese që fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.623/2022

Ilire Mehmeti Shaqiri

Procesmbajtëse

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

